

KONTRATA SOCIALE FIER

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "EPOKA E RE"



Suedi
Sverige



RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA FIER

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Gusht 2019 – Gusht 2020



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



Association for Integration of Roma and Roma



"Intelektualet e rinj, Shpresa"





Suedi
Sverige



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport është Përgatitur nga Epoka e Re në kuadër të projektit POP 2019 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



lëvizja rinore
për demokraci



Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	4
FALENDERIME	5
HYRJE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
GJETJET	9
KONTRATAT SOCIALE BASHKIA FIER	9
KËSHILLI BASHKIAK FIER	11
MBLEDHJET E KËSHILLIT TË BASHKISË FIER	11
GJETJE NGA BASHKIA FIER	12
GJETJE NGA KOMUNITETI	13
ANALIZA E PRIORITETEVE	16
PRIORITET 1: TRANSPARENCA	16
PRIORITET 2 : INFRASTRUKTURA	18
PRIORITET 3: SHËRBITIMET SOCIALE	22
PRIORITET 4: VËMENDJE NDAJ TË RINJVE	22
PRIORITET 5: VËMENDJE NDAJ FËMIJËVE	23
REKOMANDIME	23
ANEKSE	25

Shkurtime

BF	Bashkia Fier
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
POP	Përballja e Ofertave Politike
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
COVID-19	Koronavirusi Sars – kovid
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
ZK	Zonë Kadastrale
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
V.K.B	Vendim i Këshillit Bashkiak
PBA	Buxheti Afat - Mesëm
PRP	Plani Rrugor për Pasaportën
OKD LANÇ	Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare
Kontrata Sociale ¹	Me prioritete të përzgjedhura nga komuniteti në vitin 2019

¹ <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-fier/>

Falenderime

Falenderime për të gjithë personat që bashkëpunuan për këtë produkt kaq të thjeshtë, por specifik. Falenderojmë Bashkinë Fier dhe Këshillin e Bashkisë Fier për vullnetin, disponibilitetin e mbështetjen që i kanë dhënë projektit gjatë kësaj periudhe, si dhe motivimin dhënë të rinjve/grupit monitories në të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga ky këshill. Falenderime të gjithë qytetarëve që pranuan të bëheshin pjesë e intervistave/fokus grupeve tona.

Faleminderit të rinjve vullnetarë të qendrës Epoka e Re, të cilët kanë qenë mjaft aktiv gjatë kësaj kohe dhe kanë monitoruar me sukses të gjithë aktivitetin e Këshillit Bashkiak Fier, Bashkisë Fier, si dhe monitorimin e zbatueshmërisë së premtimeve që rrjedhin nga Kontrata Sociale POP - 2019.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë *Olof Palme International Center* dhe *NED – National Endowment for Democracy* për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "*Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)*" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjatë fushtës Elektorale ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të të rinjve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e të rinjve dhe më pas prezantimit të përparësive të zgjedhura për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që të rinjtë të kenë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Forumet publike me të rinj dhe komunitetin kanë adresuar çështjet e shërbimeve publike; Qeverisja e mirë lokale; zhvillimi ekonomik lokal dhe dimensionin social. Kontakti i drejtpërdrejtë me të rinjtë në shkollat e mesme nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritetet e të rinjve dhe komuniteteve të tyre.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "*Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.*" Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën Gusht 2019 – Gusht 2020

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Epoka e Re, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë periudhës gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- ¶ Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- ¶ Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- ¶ Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- ¶ Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- ¶ Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve mars – qershor 2020 fokus të vecantë iu kushtua menaxhimit të situatës Covid 19, vendimarrjes së këshillit Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Fier².

² https://popalbania.info/wp-content/uploads/2020/05/Raporti_Bashkia-Fier_COVID-19-1.pdf

Përmbledhje Ekzekutive

Evidentimi i prioriteteve të komunitetit, hartimi i kontratës sociale, lobimi dhe advokimi për përmbushjen e tyre ishte fokusi i punës së projektit POP gjatë periudhës gusht 2019 – gusht 2020 në Bashkinë Fier.

Prania e koronavirusit COVID-19 dhe shpallja e pandemisë në mbarë botën devijoi edhe objektivin e POP gjatë periudhës së parë të vitit 2020, kryesisht për periudhën e kufizimit të lëvizjeve/aktiviteteve dhe karantinës së detyruar. Gjatë periudhës Mars – Maj, anëtarët e rrjetit POP, monitoruan reagimin e qeverisjes vendore si dhe problemet e komunitetit. Monitorimi i Epokës së Re u bazua në veprimet dhe mosveprimet institucionale, bazuar në urdhëresa dhe vendime të ndryshme që qeveria shqiptare ndërmori gjatë kësaj kohe, si dhe në përmbushje të ligjit për vetëqeverisjen vendore.

Në kushtet e izolimit shumë prej target-grupeve janë kontaktuar nëpërmjet telefonit, internetit ose takime në distancë të shkurtër pa praninë e një të treti. Kjo për të ruajtur distancën sociale dhe kushtet e vetëizolimit.

Grupet që u kontaktuan dhe u bënë pjesë e këtij raporti ishin: Pensionistët; grupet PAK; Gratë e punësuar në fasoneri, gratë e prekura/kërcënuara/me urdhër mbrojtje të dhunës në familje; të rinj; biznese (biznesmenë); komuniteti rom/egjiptian; nxënës/prindër; përfaqësues të Bashkisë Fier.

Pas grumbullimit të të dhënave, klasifikimit dhe strukturimit të tyre, në muajin maj, raportet kaluan në një fazë të dytë, atë të përballjes së gjetjeve dhe prezantimit të rekomandimeve. Epoka e Re e pa të rëndësishme prezantimin e tyre përballë bashkisë, anëtarëve të Këshillit Bashkiak, por edhe përballë të rinjve. Takimet u zhvilluan online dhe në sallë, në formën e diskutimeve dhe dhënies së mendimeve për vënien në zbatim në mënyrë sa më efikase të gjetjeve të raportit. Raporti është përgëzuar jo vetëm për informacionin që mbarte, seriozitetin dhe profesionalizmin, por edhe për punën e bërë në kushte të vështira, pa lënë mënjane asnjë fushë veprimi.

Pas një periudhë të gjatë kufizimi të aktivitetit fizik në salla dhe takime, në muajin qershor, mbledhja e radhës së Këshillit të Bashkisë Fier u zhvillua në sallë dhe u transmetua Live në platformën Facebook/Bashkia Fier. Ky ishte takimi i vetëm që u zhvillua në sallë me prezencën e anëtarëve të këshillit, pasi që nga ky moment e deri me sot (30 gusht 2020), mbledhjet e këshillit vazhdojnë të mbahen online, në formatin skype.

Gjetjet

- ¶ Këshilli i Bashkisë Fier përbëhet nga 51 anëtarë
- ¶ Këshilli i bashkisë Fier ka 12 komisione të përhershme.
- ¶ Këshilli i Bashkisë Fier është konstituuar më 29.07.2019.
- ¶ Mbledhja e parë e Këshillit të Bashkisë Fier pas konstituimit është zhvilluar më 11.09.2019.
- ¶ Gjatë periudhës 29.07.2019 – 30. 08.2020 Këshilli i Bashkisë Fier ka marrë 132 vendime, 76 prej të cilave kanë ndikim indirect ose direct në përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, pjesë e kontratës 2019.
- ¶ Mendimi qytetar për evidentimin dhe selektimin e prioriteteve është marrë në disa mënyra: nëpërmjet fokus grupeve, takimeve të drejtëpërdrejta, intervistave të strukturuar.
- ¶ Të rinjtë kanë qenë pjesa më aktive e zbatimit të këtij projekti në Bashkinë Fier.
- ¶ Të rinjtë – pjesëmarrës permanent në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Fier.
- ¶ Të rinjtë – aktiv në monitorimin dhe advokimin e përmbushjes së kontratës sociale si në qytet ashtu dhe në njësi administrative.

Kontratata Sociale Bashkia Fier

Nisma e rrjetit POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim është hartuar Kontrata Sociale për të gjitha bashkitë, ku organizatat e rrjetit operojnë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë. Kontrata Sociale është një dokument i hartuar me prioritetet e qytetarëve nga takime, fokus grupe dhe forume të organizuara gjatë periudhës parazgjedhore 2019. Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

- ¶ Shërbimet Publike
- ¶ Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja
- ¶ Zhvillimi Ekonomik Vendor
- ¶ Dimensioni Social në Nivel Vendor

Kontratata Sociale nuk janë thjesht një premtim i shkruar, por një angazhim për kryetarët e zgjedhur për të përmbushur këto prioritate brenda katër vjeçarit të mandatit të tyre.

Kontrata sociale e Bashkisë Fier u formalizua më 17 tetor 2019, me dakortësimin/firmosjen e saj nga: Kryetari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi, Kryetari i Këshillit Bashkiak Fier Z. Vangjel Ndreko dhe Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Epoka e Re Fier Znj. Nevila Jahaj.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia dhe Këshilli Bashkiak angazhohen në realizimin e disa çështjeve që për komunitetin dhe kryesisht për të rinjtë janë prioritare. Kjo kontratë u firmos gjatë një Forumi Publik me pjesëmarrjen e të rinjve, shoqërisë civile, grupeve të interesit, qytetarëve e Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier.

Puna për përgatitjen e saj nisi muaj më parë. Përpara përpilimit të kësaj kontrate sociale u arrit grumbullimi i mendimit dhe prioriteteve të qytetarëve/të rinjve. U realizuan disa fokus grupe dhe u studiua e gjithë situata në territorin e Bashkisë Fier, shpërndarë në problematika e shërbime reale, marrëdhëniet e ndërveprimet komunitet/të rinj, qeverisje vendore etj.

Informacioni dhe rezultatet e grumbulluara nga këto zhvillime, u ndanë dhe selektuan në bazë prioritetesh nga të cilat u zgjodhën po nga të rinjtë nëpërmjet procesit fokus grup, ato më të rëndësishme dhe emergjente të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre/komunitetit.

Prioritetet e përzgjedhura nga të rinjtë/komuniteti i Fierit, janë të shtrira në 5 shtylla kryesore, si më poshtë vijon:

1. Transparenca

Transparenca në menaxhinin e Njesisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjuesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

2. Infrastruktura

Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.

3. Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

4. Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtorie) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

5. Vëmendje ndaj fëmijëve

Kthimi në identitetin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.

Këshilli Bashkiak Fier

Këshilli Bashkiak Fier deri në vitin 2019 kishte në përbërje të tij 41 anëtarë. Rritja e popullsisë në vitin 2018 në Bashkinë Fier, duke kaluar kufirin e 200 000 banorëve e çoi numrin e anëtarëve të Këshillit (korrik 2019) në 51. Këshilli i ri i Bashkisë Fier është konstituuar më 29 korrik 2019 ka në përbërje të tij 51 anëtarë.

Mbeshtetur ne piken a) te nenit 54 te Ligjit nr. 139/2015 dt 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore dhe ne Rregulloren e Funksionimit te Keshillit te Bashkise FIER, miratuar me Vendimin e Keshillit te Bashkise nr. 63 dt 04.09.2007 kapitulli IX neni 35, Keshilli I Bashkise Fier në mbledhjen e datës 07.10.2019 vendosi krijimin e komisioneve të përhershme.

Komisionet e përhershme:

- ¶ Komisioni I Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve
- ¶ Komisioni Juridik dhe I çështjeve Institucionale
- ¶ Komisioni për Punët Publike dhe Emergjencat
- ¶ Komisioni I Çështjeve Sociale
- ¶ Komisioni për Çështjet e Zhvillimit Urban, Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Shëndetit Publik.
- ¶ Komisioni I Arsimit, Kulturës, Sportit dhe i Marrëdhënieve me jashtë.
- ¶ Komisioni I Auditit.
- ¶ Komisioni I Votimit
- ¶ Komisioni për Mbikqyrjen, Kontrollin dhe Nënshkrimin e Proces – Verbaleve të Mbledhjes.
- ¶ Komisioni për Zhvillimet Bujqësore, Blegtorile dhe të Agrobiznesit.
- ¶ Komisioni për Barazinë Gjinore
- ¶ Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Shpalljen ose Njohjen e Statusit të "Dëshmorëve të Atdheut".

Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Fier

Një nga elementet kryesore të POP 2020 është monitorimi i mbledhjeve dhe vendimeve që dalin nga Këshilli i Bashkisë Fier.

Gjatë gjithë periudhës, që nga moment i konstituimit e deri në 30 gusht 2020, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 132 vendime, 76 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirect në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.

Që prej muajit mars 2020 e në vazhdim (gusht 2020) mbledhjet e Këshillit Bashkiak/komisioneve zhvillohen online në formatin Skype.

Gjetje nga Bashkia Fier

Informacionet nga Bashkia Fier janë marrë nëpërmjet një shkrese zyrtare dërguar në emër të projektit POP dhe nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta me secilën drejtori respektive që lidhet me përmbushjen e pikave të kontratës sociale.

Transparenca

- ¶ Në kuadër të transparencës Bashkia Fier është angazhuar maksimalisht. Ajo përdor disa mënyra për të shpërndarë informacionin dhe për të marrë ankesë – kërkesat e qytetarëve.
- ¶ Publikimet në vendet me akses të gjerë;
- ¶ Publikimet në faqen zyrtare të bashkisë;
- ¶ Publikimet në rrjete sociale;
- ¶ Bashkëpunimi me mediat locale për shpërndarje më të gjerë të informacionit;
- ¶ Vendosja e kutive të ankesave në çdo Nj.A. dhe trajtimi i tyre në mënyrë periodike;
- ¶ Praktika disavjeçare e procesit Buxhetim me pjesëmarrje;
- ¶ Takimet e drejtëpërdrejta të Kryetarit të Bashkisë me komunitetin në zonat e banuara;
- ¶ Konsultimet publike për çështje prioritare dhe të rëndësishme;
- ¶ Konsultimet publike për projekte të rëndësishme zhvillimore etj;
- ¶ Bashkia Fier e sheh të rëndësishme edhe prezencën e të rinjve në Mbledhjet e Këshillit bashkiak dhe ndikimin e tyre në vendimmarrjen lokale.

Infrastruktura

- ¶ Bashkia Fier gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare ka ndërhyrë pothuajse në të gjitha institucionet arsimore. Diku me rikonstrukcion të plotë, diku restaurime dhe në të gjitha sistemim e dezinfektim. Kemi ndërtuar një shkollë të re e cila u shemb për shkak se ishte tejet e amortizuar, shkolla e Darëzezës së Re. kemi ndërtuar dhe përshtatur (rehabilituar) disa terrene sportive në shkolla dhe hapsira publike në qytet dhe Nj.A.
- ¶ Në të gjitha shkollat që kanë pësuar rikonstrukcion të plotë janë krijuar mundësitë e funksionimit të tyre si qendra komunitare, por situata e pazakontë e krijuar nga pandemia e ka lënë në mes këtë proces.

Shërbimet sociale

Bashkia Fier është e gatshme të bashkëfinancojë në ngritjen e një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë. Për këtë po lobon për gjetjen e donatorëve të mundshëm pasi e vetme nuk mund të mbulojë gjithë financimin.

Vëmendje ndaj të rinjve

Në buxhetin e Bashkisë Fier ende nuk ka një zë të veçantë për të rinjtë.

Vëmendje ndaj fëmijëve

Fuqizimi i Qendrës së Aktiviteteve Kulturore (dikur QKF) është një prioritet edhe i Bashkisë Fier. Për këtë qëllim Kryetari i Bashkisë ka menduar që ta kthejë atë jo vetëm në një qendër për fëmijët, por të ketë një gjithëpërfshirje edhe të të rinjve. Sot në këtë qendër funksionojë:

- ¶ Grupi i këngës
- ¶ Grupi i letrarëve/gazetarisë
- ¶ Grupi i pikturës
- ¶ Grupi i kërcimit
- ¶ Grupi i sporteve (volejball, futboll)
- ¶ Grupi i shahut
- ¶ Grupet më të popullarizuara janë: sported dhe kërcimi. Grupmosha varion nga 5-18 vjeç.
- ¶ Kjo qendër organizon edhe shumë aktivitete artistike, kulturore e sportive.

Gjetje nga komuniteti

Në muajin gusht 2020, qendra Epoka e Re zhvilloi disa fokus grupe me qëllim trajtimin e prioritetëve të kontratës sociale. Target grupet e synuara ishin: gratë, të rinjtë, komunitet të zonave rurale, përfshirë grupet e marginalizuara, komuniteti i bashkisë qendër (qytet), të rinjtë e zonave rurale.

Takimet u zhvilluan në harkun kohor 90' dhe u diskutuan të gjitha prioritetet e kontratës sociale, por dhe performanca e bashkisë dhe shërbimeve në përgjithësi.

Për shkak të situatës pandemike, numri i pjesëmarrësve ishte i kufizuar, 8-10 pjesëmarrës në çdo takim. Takimet u zhvilluan nën respektimin e masave mbrojtëse anti-covid (maska, dezinfektues, distancë sociale).

- ¶ **Transparenca** në menaxhimin e njësive të qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike.
- ¶ Në përgjithësi nga të gjithë kishte një qasje pozitive të qeverisjes vendore në lidhje me njoftimet publike si në afishimin e tyre në zonat e caktuara publike (ambientet e NJA, Bashkisë) ashtu dhe në rrjete sociale. Në këtë të fundit ndryshimi ndjehet edhe më shumë. Pavarësisht këtij ndryshimi të lehtë kërkohet një angazhim më i madh në mënyrën e këtyre njoftimeve pasi shpesh herë komuniteti nuk njihet me to nëse nuk interesohet vetë herë pas here. Duhet të gjenden mekanizma për ta imponuar

informacionin tek pjesa më e madhe e komunitetit për të zbehur indiferencën e tyre të akumuluar vit pas viti.

- ¶ Jo të gjithë e kanë interesin për mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Një pjesë e mirë e pjesëmarrësve që përdorin rrjetet sociale e kanë informacionin e takimeve të Këshillit, por pjesa tjetër jo. Disa prej tyre kanë qenë prezent kur kanë patur çështje personale që duhej trajtuar nga Këshilli i Bashkisë, por si komunitet (pa interes personal në ndonjë çështje konkrete) asnjë prej tyre nuk ka qenë pjesë e këtyre takimeve, përjashtuar të rinjtë. Pjesa më e madhe e të rinjve, të organizuar nga qendra Epoka e Re, kanë frekuentuar vazhdimisht mbledhjet e këshillit, takimet publike, dëgjuesat etj. Situata e fundit që krijoi pandemia e rriti nuk e zbehu interesin e tyre edhe gjatë takimeve të zhvilluara online.
- ¶ Pothuajse të gjithë kishin informacion mbi zhvillimin e takimeve për buxhetin e vitit pasardhës, edhe pse në terma të ndryshme. Vetëm pak prej tyre kanë qenë pjesë e këtyre takimeve. Një pjesë janë shprehur se nuk e kanë marrë vesh në kohë për orën, vendin e takimit në zonën e tyre, kurse një pjesë e kanë injoruar si informacion për shkak të humbjes së besimit. Situata e krijuar këtë vit e vë në pikëpyetje ecurinë e këtij procesi për vitin 2021.
- ¶ Pothuajse të gjithë nuk dinin se si do të jetë ky proces në vazhdim për shkak të evitimit të grumbullimeve masive. Nuk kanë dijeni për mënyrat e tjera alternative të marrjes së prioritetëve të komunitetit. Pak prej pjesëmarrësve në fokus grupe kishin informacion për marrjen e mendimit qytetar nëpërmjet portalit buxhetim.al. Nuk kanë asnjë informacion tjetër për mënyrën e përzgjedhur nga bashkia për marrjen e mendimit qytetar, përveç nëpërmjet takimeve direkte me kryetarin e Bashkisë, administratortin e njësisë dhe kryeplakun.

Infrastruktura

- ¶ Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.
- ¶ Situata e shkollave dhe terreneve sportive në gjithë territorin e Bashkisë Fier edhe pse është më e mirë se një vit më parë, përsëri ka shumë probleme të pazgjidhura.
- ¶ Një qytetare, banore e njësisë administrative Portëz ngre shqetësimin për sistemimin e oborrit të shkollës dhe ndërtimin/sistemimin e një terreni sportiv për fëmijët.
- ¶ Banorja e njësisë administrative Frakull kërkon sistemimin e fushës së sportit, pasi ka hapësirat e duhura, por jo kushtet.
- ¶ Banoret e njësive Qendër dhe Mbrostar janë shprehur se shikojnë më shumë vëmendje dhe angazhim nga qeverisja vendore gjatë këtyre viteve si për shkollat ashtu dhe fushat e sportit, por përsëri nrezultatet nuk janë ato të pritshmet. Ata janë shprehur se duhet më shumë investime në fushën e arsimit dhe infrastrukturës së edukimit fizik, pasi në

shumë fshatra një gjë e tillë mungon kretësisht. Fëmijët as nuk bëjnë fiskulturë dhe jo më të argëtohen në kohën e lirë.

- ¶ Shumë prej pjesëmarrësve në takime dhe intervista individuale u shprehën se situata e shkollave dhe terreneve sportive ka ardhur duke u përmirësuar, por ka ende shumë institucione arsimore dhe zona që mbartin problemin e infrastrukturës në fusha/palestra/terrene sportive.

Përsa i përket funksionimit të shkollave si qendra komunitare ende nuk ka përparim. Situata pandemike, rreziku i dëmtimit të shkollave të rikonstruara dhe mungesa e stafit mbështetës për periudhën post shkollore janë pengesat që kanë çuar në këtë mosrealizim. Disa prej shkollave që pak kohë më parë shërbenin si qendra komunitare, për shkak të ndikimit të komunitetit të prindërve për mbrojtje të ambjenteve, pandemisë dhe mungesës së mbikqyrjes jashtëshkollore ka bërë që të mbyllen e të mos funksionojnë më si të tilla.

Në disa shkolla frekuntohen vetëm terrenet sportive, të cilat shërbejnë vetëm si fusha loje për fëmijët/të rinjtë, por jo për të gjithë komunitetin. Pjesëmarrësit janë shprehur se ka përmirësim në infrastrukturën e disa shkollave dhe janë gati për t'u frekuentuar si qendra komunitare, por asgjë nuk është bërë deri tani. Kërkohej gjithashtu më shumë vëmendje nga bashkia për të nërhurë jo vetëm në disa shkolla, por në të gjitha pasi gjendja e pjesës më të madhe të shkollave lënë për të dëshiruar, sidomos ato në zonat rurale.

Disa prej të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në fokus grupe kanë ngritur shqetësimin për vënien në funksion të qendrës komunitare në Seman. Ata janë shprehur se kjo qendër kërkon vetëm ndërhyrje të pjeshme infrastrukturore dhe ofrimin e shërbimeve. Ata kërkuan nga projekti POP vazhdimin e lobimit për rivënien në funksion të saj si mënyra më e mirë për të vitalizuar jetën në këtë zonë rurale.

Asnjë prej pjesëtarëve të komunitetit nuk kishte informacion nëse ekzistojnë programe mbështetëse për komunitetin nëpërmjet ndërtimit të qendrave komunitare në njësitë administrative, ose përpjekje për këtë gjë.

Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

Të gjithë të intervistuarit, pa dallim gjinie, moshe apo përkatësie ishin dakord për ngritjen e një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë, por nuk kishin asnjë informacion në lidhje me përpjekjet e Bashkisë Fier për realizimin e këtij prioriteti. Disa prej tyre sugjeruan që në këtë qendër të përfshihej edhe shërbimi psikologjik për të rinjtë si një nevojë

në rritje për shoqërinë. Një tjetër sugjerim tyre ishte ngritja e kurseve profesionale për gratë e dhunuara për ti aftësuar ato për tregun e punës. Ata kërkuar vazhdimin dhe intensifikimin e angazhimit të Qendrës Epoka e Re dhe të rinjve nëpërmjet ndikimit të tyre në qeverisjen lokale, për të nxitur investimin për këtë qendër.

Vëmendje ndaj të rinjve

- ¶ Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (drejtorie) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.
- ¶ Të gjithë ishin në një zë për një buxhet të dedikuar vetëm për të rinjtë. Kjo do u japë mundësi të gjenerojnë aktivitete të reja dhe ndërmarrin nisma në shërbim të fuqizimit të tyre dhe ndikimit të komunitetit në vendimmarrje.
- ¶ Të intervistuarit ishin të bindur në ndikimin e Këshillit Rinor, duke e parë si një mënyrë për të depërtuar në vendimmarrjen lokale.
- ¶ Kishin informacion që një nismë e tillë është ndërmarrë nga Epoka e Re edhe pse nuk është formalizuar ende.

Vëmendje ndaj fëmijëve

- ¶ Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet dhe kurset jashtë-shkollorë të fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.
- ¶ Për të gjithë pjesëmarrësit, kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, sot Qendra e Aktiviteteve Kulturore (QAK), duke rikthyer gjithashtu grupet, kurset jashtë-shkollorë të fëmijëve, është një nevojë imediate. Shumë grupe fëmijësh ndihen të papërfaqësuar dhe të paorientuar.
- ¶ Ringritja e këtij institucioni do t'i ndihmojë fëmijët të dinë të orientohen drejt prirjeve dhe kapaciteteve të tyre, bazuar dhe në aftësimin profesional. Për ta kjo qendër pothuajse nuk funksionon.

Analiza e prioriteteve

Prioritet 1: Transparenca

Nga monitorimet e bëra gjatë kësaj periudhe nga Epoka e Re, në lidhje me transparencën e Bashkisë Fier është vënë re një tendencë për rritjen e saj si një objektiv për të përmbushur kontratën sociale të lidhur mes institucionit të qeverisjes vendore dhe Opokës së Re, në kudër të projektit POP 2019. Ndihet vëmendja që I kushtohet njoftimeve për: mbledhjet e Këshillit

Bashkiak, informimi për raste specifike, informimi për taksat dhe tarifat vendore... etj, jo vetëm në faqen zyrtare të Bashkisë, rrjetet sociale, por edhe në afishimin e tyre në ambientet publike, lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët si në qytet (Bashki qendër) ashtu edhe në Njësitë Administrative.

Gjatë periudhës Mars – Qershor 2020, periudha e izolimit social për shkak të pandemisë COVID-19, edhe pse pati një tkurrje të takimeve të drejtëpërdrejta nuk e uli këtë tendencë të nxitur edhe nga të rinjtë aktiv të Epokës së Re (në kuadër të projektit POP). Të gjitha takimet e organizuara virtualisht janë komunikuar me të rinjtë dhe madje ata kanë qenë të ftuar të merrnin pjesë në lëto lidhje online nëpërmjet platformës SKYPE. Këto takime janë pasqyruar në rrjetet sociale edhe nga ana e Bashkisë Fier për të mbajtur të informuar publikun në kuadër të transparencës.

Një aspekt i rëndësishëm është hartimi i një rregulloreje të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, e cila ka kaluar edhe miratimin e Këshillit Bashkiak, duke e bërë procesin edhe më të rëndësishëm me prezencën e detyrueshme të anëtarëve të këshillit Bashkiak (në zonat që ata përfaqësojnë dhe anëtarët e komisioneve për çështjet e trajtuara prej tyre).

Aktualisht në cdo njësi administrative, përfshirë dhe Bashkinë Qendër janë vendosur kuti ankesash për qytetarët. Këtu kushdo qytetar që ka një ankesë, por dhe kërkesë a sugjerim për çështje të ndryshme që prek komunitetin/qytetin/njësinë ka mundësinë dhe aksesin e plotë për ta hedhur atë në mënyrë anonime ose dhe me emër konkret. Këto ankesa/sugjerime/mendime të qytetarëve, shqyrtohen në mënyrë periodike (nga 1 – 4 javë) nga një komision i përbërë nga Nënkretarë Bashkie dhe drejtorë kryesisht të sektorëve të shërbimeve publike.

Situata pandemike nuk ka lënë mundësi të grumbullimeve masive, por duhet theksuar se mendimi qytetar është marrë nëpërmjet telefonave, personave të kontaktit për cdo zonë e njësi, si dhe në mënyrë virtuale. Pjesë të rëndësishme të këtij procesi ka luajtur edhe platforma buxhetim.al, ku janë klasifikuar lehtësisht nevojat e komunitetit edhe nga ana e Bashkisë Fier. Gjatë kësaj periudhe të rinjtë e Epokës së Re kanë kontribuar në grumbullimin e nevojave të qytetarëve dhe përcjelljen e tyre tek njësitë e qeverisjes vendore duke e monitoruar zgjidhjen deri në fund, qoftë kjo për mbështetjen e njerëzve në nevojë, apo për problematika konkrete në qytet dhe fshat.

Kjo është vetëm një pjesë e asaj dukshmërie, pasi ka shumë për të ndryshuar. Edhe pse njoftimet bëhen për mbledhjet e këshillit, konsultimin public, dëgjesa për çështje prioritare etj, ka një ngërç që mbetet i pazgjidhur. Këto njoftime nuk depërtojnë njësoj tek të gjithë qytetarët. shpesh herë shumë qytetarë nuk arrijnë të informohen në kohë, ndoshta dhe fare për këto organizime edhe pse kanë dëshirë/nevojë të marrin pjesë. Shumë të tjerë informohen shkarazi

ose gabim duke shtuar edhe më tepër pasivitetin për tu bërë pjesë e këtyre takimeve. Ende nuk ka një kanal gjithëpërfshirës informimi për të depërtuar njësoj, në kohë dhe hapësirë tek të gjithë qytetarët.


Prioritet 2 : Infrastruktura

Falë bashkëpunimit me Bashkinë Fier, angazhimit të projektit POP nëpërmjet nxitjes (kontrata sociale), kërkesës së vazhdueshme të të rinjve për shtimin e terreneve sportive kryesisht në zonat rurale, rikonstruksionin e shkollave, si dhe vullnetit të qeverisjes vendore janë arritur këto rezultate:

Është duke u ndërtuar godina dhe gjithë infrastruktura e shkollës në fshatin Darëzezë, përfshirë dhe terrenin sportiv. Duhet të intensifikohet nxitja për përfshirjen e sa më shumë shkollave në rikonstruksion dhe krijimin e terreneve sportive në pjesën më të madhe të tyre pasi ose nuk ekzistojnë, ose nuk kanë kushtet minimale për të funksionuar.



Është lancuar projekti i stadiumit të ri të qytetit (një bashkëfinancim I FSHF, Bashkisë Fier dhe Qeverisë Shqiptare). Duhet të vazhdojë lobimi i të rinjve dhe projektit që të sigurohet financimi.



Është në përfundim rikonstruksioni i terreneve sportive pranë ETC. lobimi dhe angazhimi i projektit do të nxisë mirëfunksionimin e tyre, me synim gjithëpërfshirjen sociale.

Hapsira të reja multifunksionale janë duke u ndërtuar pranë stadiumit “Loni Papuciu”, Fier, gjë që kërkon gjithashtu nga ana e projektit të llojëve për krijimin e një kalendari aktiviteteve dhe shpërndarje informacioni nëpër shkolla për mënyrën e funksionimit të tyre.



Është gati projekti i Pallatit të Sportit të qytetit, si një godinë multifunksionale, por që mbetet peng e mungesës së fondeve. Ky do të jetë një mision në vijim për advokimin dhe lobimin me Bashkinë Fier dhe donator të ndryshëm për të gjetur mundësinë e financimit.



Ka përfunduar rikonstruksioni i shkollës së mesme “Jovan Ndreko”, Libofshë, përfshirë edhe terrenin sportiv.



Ka përfunduar ndërtimi i terrenit sportiv, pranë shkollës së Cakranit, Fier, edhe pse fusha e sportit në këtë zonë pothuajse është jashtë funksionit për shkak të infrastrukturës së rënduar. Banorët shprehen se ajo që duan ata për fëmijët dhe për gjithë komunitetin është rehabilitimi i kësaj fushe.



Ka përfunduar rikonstrukcioni i shkollës 9 vjeçare “Pinellopi Pirro”, Fier, e cila ndodhej në kushte të rënduar higjieno – sanitare dhe në përgjithësi infrastrukturore. Në gjendje të rënduar ndodhen edhe shumë shkolla të tjera si në qytet ashtu dhe në zona rurale.



Ka përfunduar ndërhyrja në godinën e shkollës së Baltëzës, me numrin më të madh të komunitetit Rom. Në këtë shkollë janë ndërtuar edhe tualetet (të reja) të munguara më parë.



Përsa i përket funksionimit të shkollave si qendra komunitare, nga monitorimi, informacionet e marra nga komuniteti dhe Bashkia Fier të gjitha investimet e bëra në të gjitha shkollat e Bashkisë Fier deri më sot kanë qenë me fokus të transformimit të tyre edhe si qendra

komunitare në ato zona ku shihet e nevojshme bazuar në sipërfaqen territoriale dhe interesin që vet komuniteti shfaq. Problemi qëndron në mungesën e një stafi mbikqyrës gjatë funksionimit të tyre si qendra komunitare jo vetëm për ambientet, por dhe asistimin me aktivitete të ndryshme sportive. Aktualisht janë vetëm pak shkolla që funksionojnë të tilla, duke shfrytëzuar vetëm ambientin nga komuniteti, kryesisht fëmijët dhe këto në qytet dhe në pak zona urbane si: Levan, Dërmënas, Libofshë, Cakran.



Në disa zona ka qenë dhe vet komuniteti i prindërve që ka kërkuar mbylljen e portës së shkollës pas përfundimit të orarit mësimor si një mënyrë mbrojtëse e ambientit të shkollës nga personat e papërgjeshëm, deri në momentin që do të ketë staf mbikqyrës nga Ministria e Arsimit. Me mbylljen e shkollave dhe vijimin e procesit mësimor online, të gjitha shkollat kanë qenë të mbyllura.

Si qendra komunitare janë përshtatur ambientet e jashtme të shkollave për ato zona ku mungon hapësira publike. Në zonat me hapësirë të mjaftueshme publike në qendër të tyre, është krijuar mundësia e një miniparku që shërben si qendër komunitare. Aktualisht kjo është një problematikë në zhvillim.

Ringritja e qendrës komunitare të Semanit është një pikë që ende nuk ka një rezultat konkret. Nga ana e Bashkisë Fier po shihet mundësia e vënies në funksion të kësaj qendre, por për momentin nuk ekzistojnë mundësitë financiare për investimin infrastrukturor dhe mbajtjen në funksion të saj me shërbime e burime njerëzore. Kjo çështje është diskutuar me organizma joqeveritare, vendase e të huaja për të suportuar financimin. Bashkia Fier është e gatshme të jetë bashkëfinancuese në këtë pikë, por e vetme nuk arrin ta mbulojë dot. Është një çështje që do të vazhdojë të lobohet nga ana e projektit për të nxitur edhe më shumë Bashkinë Fier drejt gjetjes së mbështetjes financiare.

Lajm i mirë gjatë këtij viti ishte inagurimi i një qendre të re komunitare, në qytetin e Fierit. Qendra jo pa qëllim u hap pranë banesave sociale. Duke qenë shumë afër një prej zonave të banuara nga komuniteti Rom, mund të frekuentohet lehtësisht edhe nga këta të fundit. Për shkak të situatës pandemike, kjo qendër nuk po funksionon me kapacitet të plotë. Këtu do të

fokusohet edhe advokimi I projektit në vazhdimësi për të fuqizuar këtë qendër, nxitur përfshirjen sociale në të dhe hapjen e qendrave të reja komunitare kryesisht në zonat rurale ku është shumë e nevojshme.



Prioritet 3: Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

Kjo është një çështje e diskutuar masivisht me komunitetin, kryesisht me gratë dhe është një nevojë e mbështetur si e tillë edhe nga qeverisja vendore. Hapja e një qendre të tillë shihet si një domosdoshmëri për Bashkinë Fier si një ndër qytetit me popullsi të konsiderueshme dhe në rritje, por që mund të funksionojë edhe për bashkitë e tjera të qarkut.

Nga informacionet institucionale, por dhe në rrugë operative, nga ana e kryetarit të Bashkisë Fier është lobuar gjatë takimeve me organizma ndërkombëtarë për të gjetur mbështetje financiare, ose edhe një mundësi bashkëfinancimi. Deri tani ende nuk ka një rezultat, por përpjekjet dhe angazhimi ynë për të nxitur finalizimin e ndërtimit të saj do të vazhdojë.

Prioritet 4: Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (drejtorie) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

Fatkeqësitë natyrore që prekën vendin tonë si tërmeti i 26 nëntorit 2019 ashtu dhe koronavirusi (COVID -19) si në mbarë botën e kanë larguar disi vëmendjen e kësaj çështje të rëndësishme për të rinjtë e Bashkisë Fier. Vëmendja ka qenë e fokusuar më shumë tek problemet sociale dhe ekonomike. Gjithësesi edhe kjo pikë është një çështje e hapur në vazhdimësi. Prezenca imponuese e të rinjve në takime, mbledhjet e Këshillit Bashkiak, konsultime publike si dhe formalizimi i shpejtë i Këshillit Rinor Vendor do të jetë një mundësi për ta çuar drejt zgjidhjes këtë pikë të kontratës sociale dhe do të ndikojë në rritjen e pjesmarrjes së të rinjve në vendimarrjen lokale.

Prioritet 5: Vëmendje ndaj fëmijëve

Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet dhe kurset jashtë-shkollorë të fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.

Deri dy vite më parë, sot Qendra e Aktiviteteve Kulturore emërtohej, Qendra Kulturore e Fëmijëve, dikur Shtëpia e Pionierit. Qëllimi i ngritjes së kësaj qendre ishte aktivizimi i fëmijëve me grupe sipas dëshirave, pasioneve, talenteve (këngë, muzikë, pikturë, kërcim, shah, sporte etj). Kishte dhe grupe formuese, ku punohej për aftësimin e fëmijëve në mësimxënie (orë mësimore/kurse jashtë-shkollore).

Dy vite më parë kjo qendër ndryshoi emërtimin, por rriti njëkohësisht dhe gamën e përfshirjen në të. QAK, nuk ishte më një qendër vetëm për fëmijët, por edhe për të rinjtë, me fokusin që t'i përfshijnë edhe ata në shumë aktivitete artistike, kulturore, sportive që kjo qendër organizon. Sot, pavarësisht ekzistencën së grupeve që Bashkia Fier është shprehur se janë hapur dhe funksionojnë, numri i frekuentuesve në to është o papërfillshëm. Kjo qendër është kthyer vetëm në një organizatore aktiviteteve në rast festash apo ditë të vecanta dhe jo më një burim informimi, aftësimi dhe zhvillimi. Në QAK, zyrtarisht funksionojnë grupi i letrarëve, pikturës, këngës, valles, por realisht me një frekuentim gati zero. Dy vite më parë u hapën kurset e gjuhës së huaj: gjermanisht, anglisht e italisht, por që nuk zgjatën shumë për shkak të nevojës për më shumë burime njerëzore dhe pamundësisë financiare për ta.

Situata pandemike e ka vështirësuar edhe më shumë evolimin e një vullneti që nisi pas nënshkrimit të kontratës sociale për forcimin e grupeve dhe rikthimin e kurseve jashtë-shkollore. Ekziston një vullnet institucional dhe individual i kreut të Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi për ta kthyer këtë institucion të rëndësishëm për brezin e ri, por ende nuk ka asgjë konkrete për vet faktin që kjo qendër nuk përmbush asnjë prej qëllimeve të fëmijëve dhe të rinjve. Ajo vazhdon të jetë thjesht një institucion që bën disa aktivitete në vit. Advokimi dhe lobimi edhe për këtë pikë të kontratës, e cila mbetet pa një rezultat konkret do të vazhdojë nga ana e projektit.

Rekomandime

- Formalizimi i krijimit të Këshilli Rinor Vendor do të nxisë edhe më shumë transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen e të rinjve në vendimmarrjen lokale.
- Rrjeti i organizatave të projektit POP është i duhuri për të shtyrë edhe më tej qeverisjen vendore për krijimin e një portofoli/buxheti specifik për të rinjtë, si dhe një strukturë (drejtori) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien me të rinjtë. Por ky prioritet kërkon një plan më të gjerë dhe jo vetëm lokal. Shtrirja e këtij prioriteti në nivel

kombëtar I jep formën e duhur dhe realizimin e tij definitiv, jo vetëm në një hapësirë territoriale të kufizuar sic është Fieri.

- Prezenca e të rinjve në çdo mbledhje të Këshillit Bashkiak, dëgjesa publike apo takime formale është një “presion” pozitiv që forcon pozitën e të rinjve në qeverisje vendore, gjithashtu dhe ndikimin.
- Të vijoje ndjekja e takimeve (nga të rinjtë), të organizuara nga qeverisja vendore për Buxhetin e vitit pasardhës, kryesisht në zonat rurale, si mënyra më e mirë për të afruar komunitetin në këto takime të paragjykuara. Kjo i shërben marrjes së prioriteteve të komunitetit në mënyrë sa më efektive, me qëllim shpërndarje sa më eifikase të investimeve dhe një buxheti gjithëpërfshirës.
- Situata pandemike ka krijuar një hendek të madh në mënyrën e zhvillimit të takimeve masive. Kjo na kanalizon në gjetjen e mënyrave të reja për marrjen e mendimit qytetar, i cili duhet bërë në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore dhe të rinjtë.
- Krijimi i një kalendari të përbashkët të funksionimit të shkollave si qendra komunitare me përfshirjen edhe të të rinjve vullnetarë si animatorë ose mbështetës, për të dhënë një model se si mund të funksionojë një shkollë në mungesë të burimeve permanente njerëzore.
- Organizimi i disa aktiviteteve nga të rinjtë në qendrat komunitare ekzistuese: Levan, Fier, etj, për të orientuar komunitetin drejt frekuentimit të tyre. Kjo pasi frekuentimi I këtyre qendrave është në nivel të ulët.
- Hartimi i një projekti të përbashkët mes Bashkisë Fier dhe Qendrës Epoka e Re/partnerë të tjerë, për rivënien në funksion të qendrës komunitare të Semanit. Kjo qendër ka një histori të ngritur shumë vite më parë që mbetet akoma e gjallë tek komuniteti dhe nevojitet vetëm një suport financiar.
- Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, kërkon edhe angazhimin e vet të rinjve. Nëpërmjet metodave të përzgjedhura nga vet ata, të merret mendimi I të rinjve, prindërve për nevojat dhe grupet që janë më të nevojshme për zhvillimin/aftësimin e fëmijëve.
- Paraqitja e këtyre prioriteteve, në bazë ndarje të grupeve të sugjeruara Bashkisë Fier, stafit drejtues të QAK-së, si dhe propozimi për ringritjen e grupeve ekzistuese (nëse do jenë në përputheje me mendimin e të rinjve/prindërve), krijimin e grupeve të reja.
- Intesifikim i angazhimit, kryesisht nga Bashkia Fier, për gjetjen e financimit për ndërtimin e një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.
- Vëmendje e shtuar e Bashkisë Fier për rehabilitimin e terreneve sportive në shkolla, kryesisht në zonat rurale; ndërtimin e fushave të reja sportive; rehabilitimin e fushave të sportit në zonat rurale.

Anekse

Aneks 1 Mbledhjet e Këshillit Bashkiak

Nr.	Data e mbledhjes	Vendimet	Menyra
1	29.07.2019	Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Fier në Këshillin e Qarkut Fier. Për zgjedhjen e Zv/kryetarëve të këshillit të Bashkisë Fier. Për zgjedhjen e Këryetarit të Këshillit të Bashkisë Fier. Për miratimin e mandateve të Këshilltarëve të Bashkisë Fier. Për zgjedhjen e Komisionit të Verifikimit të Mandateve. Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Fier në Këshillin e Qarkut Fier.	
2	11.09.2019	Për zgjedhjen e Sekretarit të Këshillit të Bashkisë Fier. Për krijimin e komisionit të Barazisë Gjinore. "Për miratimin e projekt dokumentit të programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2020-2022 të Bashkisë Fier dhe tavanet përfundimtare të tij. "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin korrik 2019" Për dhënien e një ambient me qira për Qendrën Komunitare për fëmijë. Për miratimin e kërkesës për akordimin e ndihmës financiare për familjen Bana, banesa e së cilës është dëmtuar nga zjarri. Për fillimin e procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të kryesisë së fshatrave. Për autorizimin e Bashkisë Fier për fillimin e procedurave të marrjes me qira të ambientit për kopshte e çerdhe për Bashkinë Fier. Për mbështetjen me ndihmë financiare të fëmijëve jetim.	
3	07.10.2019	Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin shtator 2019 Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin gusht 2019	

		Krijimi I Komisioneve të përhershme Për miratimin e dokumentacionit ligjor për të aplikuar për programet social të strehimit	
4	11.11.2019	Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin tetor 2019. Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë NR.22 DATE 19.03.2019 "Për shpronësim në interes publik që preket nga realizimi I projektit "rehabilitimi I shesheve brenda blloqeve të banimit dhe krijimi I hapësirave rekreative brenda tyre. (8 Shkurti) Mbi miratimin e tarifës së regjistrimit të futbollisteve femra të federuara, Bashkia Fier. Mbi miratimin e procedurave për heqjen e "Globit" në sheshin FITORJA, Bashkia Fier. Mbi miratimin e tabelës së distancave të rrugëve të fshatrave: Rrunggajë, Vanaj, Daullas, Zhepaj – Libofshë. Për miratimin e kërkesës për akordimin e ndihmës financiare për familjen Kishnapoli (plus bashkëpronarët) në fshatin Çlirim, NJA Qendër, e dëmtuar nga zjarri.	
5	02.12.2019	Për caktimin e kontributit të anëtarëve të Këshillit bashkiak që do të dhurojnë për rindërtimin e zonave të prekura nga tërmeti I datës 26/11/2019.	
6	10.12.2019	Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2019 Për strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2020. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2020.	
	20.12.2019	Për miratimin e buxhetit Afat Mesëm përfundimtar (PBA) 2020- 2022 të Bashkisë Fier. Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2019. Për një saktësim në VKB Nr.99, Datë 11.09.2019 "Për mbështetjen financiare të fëmijëve jetim" Për miratimin e bursave të shtetit për nxënësit që ndjekin programet mësimore pranë shkollave profesionale për vitin arsimor 2019-2020. Për miratimin e listës së familjeve aplikuese për tu trajtuar nga	

		programet sociale të strehimit, Bashkia Fier. Për miratimin e kërkesës për akordimin e ndihmës financiare për familjen Hasaj, banesa e së është dëmtuar nga tërmeti i datës 21.09.2019. Për miratimin e ndihmës së menjëhershme të shtetasit. Vladimir Muçaj për arsye shëndetësore.	
06.02.2020	“Për miratimin e dhënies pa kundërshtpërblim të pasurisë me sipërfaqe 10968 m² e llojit Terren Spotiv, që ndodhet në fshatin Daullas, Njësia Administrative Qëndër, pronë e Bashkisë Fier”. “Për miratimin e Rregullores së stacioneve të plazhit të bashkisë Fier”. “Për marrjen me qira të një ambient për kopshtin e fëmijëve të fshatit Zhupan”. “Për miratimin e rikonstruksionit të banesës së Znj. Dhimitrulla Gopo”. “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) të Bashkisë Fier”. Për një shtesë në vendimin nr.139 datë 24.12.2019 “Për miratimin e bursave të shtetit për nxënësit që ndjekin programet mësimore pranë shkollave për vitin arsimor 2019 – 2020”. “Për shtesën e të ardhurave të trashëguara në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2019 dhe të fondit për Qendrën Sociale Horizont”. Për një ndryshim të pikës nr.4 të VKB nr.91, datë 11.09.2019 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Shaban Bana, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri, nga buxheti I Bashkisë si dhe I Ministrisë së Mbrojtjes, buxheti I vitit 2019, programi “Mbrojtja Civile”.	Në sallë	
25.02.2020	Për miratimin e hartës së plazheve për vitin 2020”. Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier të qytetarëve: Lenë Ndoni Mërkuri, Theodhora Lekë Kristo, Neftali Xoxi Gega”. Për miratimin e dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kufizuar 6% për muajin janar 2020”. “Për strehim emergjent në banesat sociale dhe ndryshim të përkohshëm të tarifës nga ambient shërbimi në banesë”. Për dhënien e një ambienti pa qira për zyrën e Avokatit të Popullit”. Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Elton Gega, banues në fshatin Kraps, Njësia Administrative Portëz, e	Në sallë	

		dëmtuar nga tërmeti I datës 26.11.2019". Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.141 datë 20.12.2019 "Për miratimin e listës së familjeve aplikuese për tu trajtuar nga programet sociale të strehimit, Bashkia Fier". "Për miratimin e familjeve të pastreha që përfitojnë nga programi social I subvencionimit të qirasë në tregun e lire dhe të masës së subvencionit të kësajqiraje". Për miratimin e vlerës së qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së subvencionit të qirasë për kategoritë e familjeve të pastreha që gëzojnë përparësinë subvencionimin e qirasë në tregun e lire, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij".	
27.03.2020		Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kufizuar 6% për muajin shkurt.	Online skype
07.04.2020		Për miratimin e përfitimit të shportës ushqimore për familjet rome në nevojë, të cilat nuk janë në skemën e ndihmës ekonomik, të cilat nuk përfitojnë shportë ushqimore falas në zbatim të VKM 236 datë 19.03.2020, dhe vendimit të Komisionit Qëndror të ofrimit të Asistencës dhe pezullimin e pagesës së qirasë të banorëve të banesave sociale	Online skype
15.04.2020		Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkise, Rregullores për konsultimet publike dhe Kodin e sjelljes për funksionimin e këshillit. Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të vitit 2020. Për miratimin tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Buxhetit Afat Mesëm (PBA) 2021 – 2023 të Bashkisë Fier. Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2020. Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.	Online skype
21.05.2020		Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19". Për dhënien e ndihmës ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar 6% për muajin prill 2020".	Online skype
20.06.2020		Për miratimin e fillimit të procedurave të shpronësimit për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i zbatimit të projektit "Rehabilitimi i Lumit Gjanica - faza II, Rikonceptimi i Qendrës së Qytetit dhe ndërtimi i Pallatit të	Online skype

		Sportit të Lojërave me dorë Fier.	
30.06.2020		Për miratimin e Rregullores së Shqyrtimit dhe miratimit të peticioneve dhe iniciativave qytetare”. Për miratimin e dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kufizuar 6% për muajin maj 2020”. Për miratimin e dhënies në përdorim të pasurisë Arë me pasuri 27/1 ZK 1414 në fshatin Çlirim me sipërfaqe 29700 m², pronë e Bashkisë Fier, në të cilën do të ndërtohet një punishte për përpunimin e frutave dhe perimeve të fermerëve të zonës me sipërfaqe trualli 1496 m² dhe sipërfaqe ndërtese 345 m². Për një ndryshim në vendimin nr 134 datë 20/12/2019 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2020”. Për miratimin e ndihmës së menjëhershme Z. Ismet Merko”. Për miratimin e ndihmës për studimet e studentit me rezultate të shkëlqyera, Enklid Gëzim Hoxha”.	LIVE Në sallë
21.07.2020		Për Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Buxhetit Afat Mesëm (PBA) 2021-2023 të Bashkisë Fier”. Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier”. Për miratimin e dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kufizuar 6% për muajin qershor 2020. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit, subvencionimin e ndërtesave të kredisë”. Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Fier për vitin 2021”.	Online skype
29.07.2020		Për miratimin e pasqyrave financiare të ujësjellës kanalizime sh.a. Fier për vitin 2019”.	Online skype

Aneks 2 Kontrata Sociale

